L I G J
Nr.8837, datë 22.11.2001

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN NDËRKOMBËTARE KUNDËR MARRJES SË PENGJEVE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve" të 17 dhjetorit 1979.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3172, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Kombet e Bashkuara:
"Konventa Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve"
Kombet e Bashkuara
Asambleja e PërgjithshmeA/C 6/34/L.23
4 dhjetor 1979
Origjinali: Anglisht
Sesioni i 34-t
Komiteti i gjashtë
Pika 113 e Axhendës
Hartimi i draftit të një Konvente Ndërkombëtare kundër marrjes së Pengjeve
Republika Federale e Gjermanisë: Projektrezolutë.
Asambleja e Përgjithshme,

Duke konsideruar se zhvillimi progresiv i të drejtës ndërkombëtare dhe kodifikimi i saj ndihmojnë në realizimin e qëllimeve dhe parimeve të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Të vetëdijshëm për nevojën e përfundimit të një Konvente Ndërkombëtare, nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara, kundër marrjes së pengjeve,

Duke kujtuar rezolutën e saj 31/103 të datës 15 dhjetor 1976 me anë të të cilës u krijua një Komitetit Ad-Hoc për hartimin e draftit të një Konvente Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve dhe iu kërkua që të hartonte në një datë sa më të afërt të mundur një Konvente Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve,

Duke kujtuar më tej rezolutat e saj 32/148 të 16 dhjetorit 1977 dhe 33/19 të 29 nëntorit 1978,

Pasi ka marrë në konsideratë projekt Konventën e përgatitur nga Komiteti Ad-Hoc në përputhje me rezolutat e sipërme, 1/

Miraton dhe hap për nënshkrim dhe ratifikimin ose për aderim Konventën Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, aneksuar rezolutës së tanishme.

Aneks

Shtetet palë në këtë Konventë,

Duke pasur në mendje qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve,

Duke njohur, në veçanti, se çdo njeri ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit, siç përcaktohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike,

Duke riafirmuar parimin e të drejtave të barabarta dhe vetëvendosjes së popujve ashtu siç përcaktohet në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën mbi Parimet e të drejtës ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, ashtu si dhe rezolutat e tjera përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme,

Duke konsideruar se marrja e pengjeve është një shkelje që paraqet një shqetësim të madh për komunitetin ndërkombëtar dhe se, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, çdo person që kryen një akt të marrjes peng ose do të procedohet ose të ekstradohet,

Të bindur se ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve në hartimin dhe miratimin e masave të përshtatshme për parandalimin, procedimin dhe dënimin e të gjitha akteve të marrjes peng si shfaqje e terrorizmit ndërkombëtar,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Çdo person që kap ose ndalon dhe kërcënon të vrasë, të dëmtojë ose të vazhdojë të mbajë një person tjetër (këtu më pas i referuar si "peng") me qëllim që të detyrojë një palë të tretë, kryesisht një shtet, organizatë ndërqeveritare ndërkombëtare, një person fizik ose juridik ose një grup personash për të kryer ose për të mos kryer çfardo akti si një kusht i shprehur ose i nënkuptuar për lirimin e pengut, kryen shkeljen e marrjes së pengjeve (pengmarrje) brenda kuptimit të kësaj Konvente.

2. Çdo person që:

a) përpiqet të kryejë një akt pengmarrjeje, ose

b) merr pjesë si bashkëpunëtor i cilitdo që kryen ose përpiqet të kryej një akt pengmarrjeje

kryen gjithashtu një shkelje për qëllimet e kësaj konvente.

Neni 2

Çdo Shtet Palë do t'i bëjë shkeljet e përcaktuara në nenin 1 të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat do të marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre shkeljeve.

Neni 3

1. Shteti Palë, në territorin e të cilit pengu mbahet nga shkelësi, duhet të marrë të gjitha masat që ai i konsideron të përshtatshme për të lehtësuar situatën e pengut, në veçanti të sigurojë lirimin e tij dhe, pas lirimit të tij, të lehtësojë kur është e nevojshme, nisjen e tij.

2. Në qoftë se ndonjë objekt, të cilin shkelësi e ka përfituar si rezultat i marrjes së pengjeve, kalon në ruajtjen e një shteti palë, ai Shtet Palë duhet t'ia kthejë atë sa më shpejt që të jetë e mundur pengut ose një pale të tretë të referuar në nenin 1, ashtu si mund të jetë rasti, ose autoriteteve përkatëse.

Neni 4

Shtetet Palë do të bashkëpunojnë në parandalimin e shkeljeve të përcaktuara në nenin 1, veçanërisht nëpërmjet:

a) duke marrë të gjitha masat e zbatueshme për të parandaluar përgatitjet në territoret e tyre respektive për kryerjen e këtyre shkeljeve brenda ose jashtë territorit të tyre, duke përfshirë masat për

të parandaluar në territoret e tyre veprimtarinë e paligjshme të personave, grupeve dhe organizatave që inkurajojnë, nxisin, organizojnë ose angazhohen në kryerjen e akteve të marrjes së pengjeve,

b) duke shkëmbyer informacionin dhe duke koordinuar marrjen e masave administrative dhe masave të tjera të përshtatshme për të parandaluar kryerjen e këtyre shkeljeve.

Neni 5

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi secilën nga shkeljet e përcaktuara në nenin 1, të cilat janë kryer:

a) në territorin e tij ose në bordin e një anijeje ose avioni të regjistruar në atë shtet;

b) nga cilido prej shtetasve të tij ose, në qoftë se ai shtet e konsideron atë të përshtatshme, nga persona pa shtetësi, të cilët kanë rezidencën e zakonshme në territorin e tij;

c) me qëllim që ta detyrojë atë shtet të kryejë ose të mos kryejë ndonjë veprim, ose

d) në lidhje me një peng që është shtetas i atij shteti, në qoftë se ai shtet e konsideron atë të përshtatshme.

2. Çdo shtet Palë duhet gjithashtu të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 1 në rastet kur shkelësi i pretenduar ndodhet në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë në ndonjë nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal, të ushtruar në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 6

1. Pasi binden se rrethanat e përligjin një gjë të tillë, çdo Shtet Palë në territorin e të cilit ndodhet shkelësi i pretenduar, në përputhje me legjislacionin e tij, duhet ta mbajë atë nën arrest ose duhet të marrë masa të tjera në mënyrë që të sigurohet prania e tij, për aq kohë sa është e nevojshme, për të bërë të mundur ndërmarrjen e çfarëdo procedure penale ose ekstradimi. Ai shtet Palë duhet menjëherë të bëjë hetime paraprake mbi faktet.

2. Arresti ose masat e tjera të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'u njoftohen pa vonesë direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara:

a) shtetit ku, është kryer shkelja;

b) shtetit kundër të cilit është drejtuar presioni ose është tenduar të drejtohet;

c) shtetit, shtetas i të cilit është personi juridik apo fizik kundër të cilit është drejtuar presioni ose është tentuar të drejtohet;

d) shtetit, shtetas i të cilit është pengu, ose në territorin e të cilit ai ka rezidencën e tij të zakonshme;

e) shtetit, shtetas i të cilit është shkelësi i pretenduar ose, në qoftë se ai është person pa shtetësi, në territorin e të cilit ai ka rezidencën e tij të zakonshme;

f) organizatës ndërqeveritare ndërkombëtare kundër të cilës është drejtuar presioni ose është tentuar të drejtohet;

g) të gjitha shtetet e tjera të interesuara.

3. Çdo person ndaj të cilit janë duke u marrë masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, ka të drejtë:

a) të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin e përshtatshëm më të afërt të shtetit shtetas i të cilit ai është ose të shtetit që në një mënyrë tjetër është i detyruar të vendosë një komunikim të tillë ose në qoftë se ai është person pa shtetësi, shteti në terrritorin e të cilit ai ka rezidencën e tij të zakonshme;

b) të vizitohet nga përfaqësuesi i atij shteti.

4. Të drejtat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni duhet të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit në territorin e të cilit shkelësi i pretenduar është i pranishëm, sipas klauzolës që ligjet dhe rregullat në fjalë duhet të bëjnë të mundur dhënien e veprimit të plotë të qëllimeve që synojnë të drejtat që përshkruhen sipas paragrait 3 të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni nuk do të paragjykojnë të drejtën e çdo Shteti Palë që ka (një) pretendim për juridiksionin në përputhje me nenin 5, paragrafi 1(b) për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq që të komunikojë dhe vizitojë shkelësin e pretenduar.

6. Shteti që bën hetimin paraprak të synuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i raportojë menjëherë rezultatet e tij shteteve ose organzatave të referuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe të tregojë se kur ka ndërmend të ushtrojë juridiksionin.

Neni 7

Shteti Palë, në të cilin ndiqet penalisht shkelësi i pretenduar duhet, në përputhje me të drejtën e tij të brendshme, t'i njoftojë rezultatin përfundimtar të procesit Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili ua transmeton informacionin shteteve të tjera interesuara dhe orgaizatave ndërqeveritare ndërkombëtare të interesuara.

Neni 8

1.Shteti Palë në territorin e të cilit shkelësi i pretenduar është i pranishëm duhet, në qoftë se ai nuk e ekstradon atë person, të jetë i detyruar, pa asnjë lloj përjashtimi dhe pavarësisht nëse shkelja kryhet në territorin e tij ose jo, të paraqesë rastin pa vonesa të pajustifikuara autoriteteve të tij kompetente me qëllim hetimi, sipas procedurave në përpëuthje me ligjet e atij shteti. Këto autoritete duhet të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e ndonjë shkeljeje tjetër të natyrës së rëndë sipas ligjit të atij shteti.

Çdo person ndaj të cilit janë duke u kryer procedurat lidhur me ndonjë nga shkeljet e përcaktuara në nenin 1 duhet t'i garantohet trajtimi i drejtë në të gjitha fazat e gjykimit, që përfshin gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive në përputhje me ligjin e shtetit në territorin e të cilit ai person është i pranishëm.

Neni 9

1. Një kërkesë për ekstradimin e një shkelësi të pretenduar, sipas kësaj Konvente, nuk duhet të jepet në qoftë se Shteti Palë i kërkuar ka arsye thelbësore për të besuar:

a) se kërkesa për ekstradim për një shkelje të përcaktuar në nenin 1 është bërë për qëllimin e procedimit ose dënimit të një personi për arsye të racës, fesë, shtetësisë, origjinës etnike të tij ose mendimit politik, ose

b) se pozita e personit mund të jetë paragjykuar;

I) për ndonjë nga arsyet e përmendura në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi, ose

II) për arsye se komunikimi me këtë person nga autoritetet përkatëse të shtetit që ka të drejtën të ushtrojë të drejtat për të mbrojtur atë nuk mund të bëhet.

2. Në lidhje me shkeljet siç përcaktohen në këtë Konventë, dispozitat e të gjithë traktateve të ekstradimit dhe rregullimet e zbatueshme midis Palëve Shtete janë modifikuar si midis Shteteve Palë deri në masën që ato janë të papajtueshme me këtë Konventë.

Neni 10

1. Shkeljet e përcaktuara në nenin 1 duhet të gjykohen për t'u përfshirë si shkelje të ekstradueshme në ndonjë traktat ekstradimi që ekziston midis shteteve Palë. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë shkelje të tilla si shkelje të ekstradueshme në çdo traktat të ardhshëm ekstradimi, që do të lidhet midis tyre.

2. Në qoftë se një shtet Palë, që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin ai nuk ka marrëveshjeje ekstradimi, në qoftë se ai vendos ta bëjë ekstradimin, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me shkeljet e përcaktuara në nenin 1. Ekstradimi do t'i nënshtrohet dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera ligjore të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

3. Shtetet Palë, të cilët nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e ndonjë marrëveshje, do t'i njohin shkeljet e përcaktuara në nenin 1 si shkelje të ekstradueshme ndërmjet njëri-tjetrit, duke ju nënshtruar dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

4. Shkeljet e përcaktuara në nenin 1 do të trajtohen, për qëllimin e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të jetë kryer jo vetëm në vendin në të cilin ai ndodhi, por gjithashtu në territoret e

shteteve, që u kërkohet të vendosin juridiksionin e tyre në përputhje me nenin 5, paragrafi 1.

Neni 11

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri - tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me hetimet ose procedurat penale të sjella në lidhje me shkeljet e përcaktuara në nenin 1, duke përfshirë dhënien e të gjitha provave në dispozicion të tyre, të nevojshme për procedimin.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni nuk duhet të ndikojnë në detyrimet që lidhen me ndihmën ligjore të ndërsjelltë (reciproke) të shprehura në ndonjë traktat tjetër.

Neni 12

Përderisa Konventat e Gjenevës të vitit 1949 për mbrojtjen e viktimave të luftës dhe Protokollet shtesë të këtyre Konventave janë të zbatueshme në një akt të veçantë pengmarrjeje (marrje pengu), dhe përderisa Shtetet Palë të Konventës janë të detyruara sipas këtyre Konventave të procedojnë (ndjekin penalisht) ose dorëzojnë pengmarrësin, Konventa e tanishme nuk duhet të zbatohen në një akt pengmarrjeje të kryer gjatë konflikteve të armatosura siç përcaktohen në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollet, duke përfshirë konfliktet e armatosura të përmendura në nenin 1, paragrafi 4, i Protokollit shtesë I të vitit 1977, në të cilin popujt luftojnë kundër sundimit kolonial dhe pushtimit të huaj dhe regjimeve raciste në ushtrimin e të drejtës së tyre për vendosje, siç përcaktohet në kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën mbi parimet e së drejtës ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 13

Kjo Konventë nuk do të zbatohet atje ku shkelja kryhet brenda një shteti të vetëm, pengu dhe shkelësi i pretenduar janë shtetas të atij shteti dhe shkelësi i pretenduar gjendet në territorin e atij shteti.

Neni 14

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të gjykohet se justifikon për shkeljen e integritetit territorial ose të pavarësisë politike të një shteti në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë në zbatimin e Traktateve mbi Azilin, në fuqi në datën e miratimit të kësaj Konvente, si midis shteteve që janë palë në ato Traktate; por dhe një Shtet Palë në këtë Konventë nuk mund të kërkojë zbatimin e këtyre Traktateve në lidhje me një Shtet tjetër Palë të kësaj Konvente që nuk janë palë e këtyre traktateve.

Neni 16

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë shteteve Palë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente që nuk zgjidhet me bisedime duhet, me kërkesën e njërit prej tyre, t'i paraqitet arbitrazhit. Në qoftë se brenda 6 muajve nga data e kërkesës për arbitrazh palët nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e arbitrazhit, çdo njëra prej këtyre palëve mund ta paraqesë mosmarrëveshjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë me anë të kërkesës, në përputhje me statusin e gjykatës.

2. Çdo shtet mundet në kohën e nënshkrimit ose ratifikimit të kësaj Konvente ose aderimit të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga paragrafi 1 i këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk duhet të detyrohen nga paragrafi 1 i këtij neni në lidhje me ndonjë shtet tjetër Palë që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni mundet në

çdo kohë të tërheqë atë rezervim me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 17

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet deri më……. Në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentat e ratifikimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga çdo shtet. Instrumentet e aderimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë që pason datën e depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit ose aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon në Konventën mbas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit ose aksesit (afrimit) Konventa do të hyjë në fuqi në të tridhjetën ditë mbas depozitimit nga një shtet i tillë i instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 19

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të njoftimit me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit mbas datës që njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 20

Origjinali i kësaj Konvente, nga i cili tekstet në arabisht, kinezçe, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëlloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i dërgojë kopjet e certifikuara të saj të gjitha Shteteve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, më ----------.